

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Departamenti: Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit



**PUNIM DIPLOME
(MASTER)**

**Ndikimi i diversifikimit të të ardhurave në nivelin e mirëqënies të banorët e
zonave rurale në regjionin e Mitrovicës**

Mentori:

Prof. Dr. Arben Musliu

Kandidatja:

Bsc. Arbesa Lushtaku

Prishtinë, 2021

Falenderime dhe mirënjohje

Pas një kohe të gjatë i erdhi fundi edhe këtij niveli studimi. E lumtur që arrita në fund të realizoj dhe këtë qëllim të jetës sime dua përzemësisht të falenderoj të gjithë stafin e pedagogëve të departamentit: Ekonomia e Bujqësis dhe Ushqimt. Me një punë të palodhur e të admirueshme na ndihmuan vërtet shumë për plotësimin dhe përmbushjen e të gjitha detyrave dhe detyrimeve që një studim master kërkon.

Falenderim special për udhëheqësin shkencor të studimit tim, Prof.Arben Musliu, për mbështetjen dhe ndihmën e çmuar gjatë gjithë periudhës së studimeve të mia, si dhe kontributin e tij në finalizimin e punimit tim të diplomës. Përveç përkrahjes së domosdoshme profesionale, mbështetja juaj morale më ka ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme dhe më ka rritur vetëbesimin.

Falenderimi më i madh është për familjen time e në veçanti për prindërit e mi të cilët as edhe një minut nuk ndaluan mbështetjen e tyre që unë të arrij sukseset e mia. Gjithë ajo çfarë jam sot unë, është meritë e juaja! Faleminderit për përkrahjen e pakursyeshme në të gjitha aspektet, ju ishit inspirimi dhe shtylla ime kryesore e rrugëtimit tim. Jam me fat që jeni pjesë e jetës sime!

Mirënjohje dhe falënderime për kontributin tuaj!

Deklarata e origjinalitetit

Unë Arbesa Lushtaku, e lindur më datë 01.12.1995 në Skenderaj, si studente e masterit në Departamentin e “AGROEKONOMISË”, para mbrojtjes së punimit të masterit, nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punimi i masterit me titull “Ndikimi i diversifikimit të ardhurave në nivelin e mirëqenies te banorët e zonave rurale në Regjionin e Mitrovicës” është puna ime origjinale, është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar më parë para ndonjë institucioni për vlerësim si dhe nuk është botuar më parë pjesërisht apo në tërësi. Deklaroj poashtu se në punim nuk përfshihet asnjë material ose botime të shkruara nga persona të tjerë përveç rasteve të cituara siç deklarohej në brendi të tekstit.

Abstrakt

Kjo teme ka për synim që të ofrojë një pasqyrë lidhur me atë se si ndikon diversifikimi i të hyrave në mirëqenien sociale të banorëve të zonave rurale në Regjionin e Mitrovices. Banorët e zonave rurale në vendin tonë kanë një nivel jo të barabartë në shpërndarjen e të ardhurave, ku si rezultat edhe mirëqenia e tyre nuk është e njëjtë. Disa kanë standard më të lartë të jetesës sepse rrethana të caktuara u kanë mundësuar qasje në burime të ndryshme të të ardhurave, për dallim prej atyre të cilët kanë burime të kufizuara ose rrjedhimisht mbështeten vetëm në një burim të të ardhurave.

Qëllim i punimit është të pasqyroj nivelin e ndikimit të diversifikimit të të hyrave në mirëqenien sociale si dhe të pasqyroj ndikimin e aktiviteteve bujqësore në rritjen e mirëqenies së banorëve të zonave rurale në regjionin e Mitrovices. Kurse, pyetje hulumtuse të punimit janë: Sa ndikon diversifikimi i të hyrave në mirëqenien sociale të banorëve të zonave rurale? Sa ndikojnë aktivitetet me karakter bujqësor në mirëqenien e banorëve të zonës rurale?

Metodologjia e studimit përbëhet nga tërësia e metodave kualitative dhe kuantitative realizuar me anë të një pyetesori si instrument për mbledhjen e të dhënave nga informatorët i strukturuar dhe i përshtatur me rrethanat e intervistimit, njohurive, aftësive, eksperiencës e në veqanti me nivelin e botëkuptimeve të të intervistuarve.

Rezultatet e arritura me anë të mbledhjes dhe analizimit të informacioneve rezultojnë se diversifikimi i të ardhurave ndikon në mirëqenien e banorëve të zonave rurale. Rekomandimi im është që institucionet e shtetit të përkrahin banorët e zonave rurale më politikat e tyre në menyrë që t'ju mundësojnë atyre të kenë llojllojshmeri të veprimtarive që ju sjellin të hyra.

Fjalët kyqe: diversifikim, të ardhura, mirëqenie, zonë rurale, Mitrovicë.

PARATHENIE

Ky punim diplome njëherit shënon edhe përfundimin e studimeve të mia në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Departamentin e Agroekonomisë respektivisht profili Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Gëzohem vërtetë nëse lexuesit e kësaj teme ndahen të kënaqur me elaborimet dhe shpjegimet që kam bërë rreth ndikimit të diversifikimit të të hyrave në nivelin e mirëqënies të banorët e zonës rurale në Regjionin e Mitrovicës, dhe shpresoj vërtetë që ky studim të ndihmojë sadopak grupet e ndryshme të interesit në njohjen e mëtutjeshme të këtij procesi.

Jemi munduar që sa do pak të pasqyrojmë gjendjen dhe zhvillimin ekonomik në zonat rurale, duke analizuar se sa është i nevojshëm diversifikimi i aktiviteteve që sigurojnë të ardhura më të larta për këta banorë si dhe ndikimi që reflekton një proces i tillë në përmirsimin e cilësisë së jetës dhe rritjen e mirëqënies.

Falënderim ju shpreh poashtu, të gjithë atyre që në një formë apo tjetër më kanë ndihmuar në realizimin e punimit duke më shërbyer me gjithë njohuritë dhe informatat përkatëse në veçanti personat e anketuar të cilet bashkpunuan pa përtes dhe pa informatat e tyre ky punim do të ishte i manget.

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|----|
| Lista e tabelave | 8 |
| KAPITULLI 1..... | 10 |
| 1. HYRJE..... | 10 |
| 1.1.1.Rrugëtimi drejt BE-së..... | 11 |
| 1.1.2.Përmisimi i standartit të jëtesës së popullatës rurale | 12 |
| 1.1.3.Fuqia punëtore në bujqësi..... | 13 |
| 1.1.4.Prodhimtaria Organike në Kosovë | 14 |
| 1.2. Sfondi i studimit dhe problemi..... | 17 |
| 1.3. Objektivi kryesorë dhe objektivat specifik të punimit | 18 |
| 1.4. Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese..... | 18 |
| KAPITULLI 2..... | 20 |
| 2. Rishikimi mbi literaturën e fushës..... | 20 |
| 2.1. Strategjia e diversifikimit..... | 21 |
| 2.2. Aksionet dhe obligacionet..... | 22 |
| 2.3. Diversifikimi me Fondet e Ndërsjella | 23 |
| 2.4. Diversifikimi mund të jetë i dobishëm edhe kur rezervat po rriten | 23 |
| 2.5. Pse kompanitë diversifikojnë? | 23 |
| 2.6. Të hyrat brenda Kosovës..... | 27 |
| KAPITULLI 3 | 30 |
| 1. Metodologjia e aplikuar..... | 30 |
| 3.1. Të dhënat e përdorura | 31 |
| 3.2. Metoda statistikore | 32 |

| | |
|------------------------------------|----|
| KAPITULLI 4..... | 32 |
| 4.1. Rezultatet e hulumtimit | 32 |
| 4.2. Testimi i hipotezave | 56 |
| KAPITULLI 5..... | 61 |
| 5.1. Përfundime | 61 |
| 5.2. Rekomandime | 62 |
| 6. Referencat | 63 |

Lista e tabelave

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Te dhënat e BMA-t për vitin 2019..... | 16 |
| Tabela 2. Format e diversifikimit | 27 |
| Tablela 3. Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë në (%)...... | 28 |
| Tablela 4. Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2016 | 29 |
| Tabela 5: Pjesmarrja e respondentëve sipas gjinisë..... | 32 |
| Tabela 6: Pjesmarrja e respondentëve sipas moshes | 33 |
| Tabela 7: Shpërndarja e pyetësorit sipas komunave..... | 33 |
| Tabela 8 : Pjesmarrja e respondentëve sipas kualifikimit profesional..... | 33 |
| Tabela 9: Punësimi i të anketuarve | 35 |
| Tabela 10: Sektori i punësimit të rrespondentëve..... | 35 |
| Tabela 11 : Zona e punësimit të respondentëve | 35 |
| Tabela 12: Numri i anëtarëve të familjes..... | 36 |
| Tabela 13: Numri i anëtarëve të punësuar në familje | 37 |
| Tabela 14: Burimet e të ardhurave të të anketuarve | 37 |
| Tabela 15 : Mbulimi i shpenzimeve me vetëm një të ardhur | 38 |
| Tabela 16: Burimet e të ardhurave që i përdorin më shumë respondentët | 39 |
| Tabela 17 : Aktivitetet nga të cilat sigurohen të ardhurat..... | 39 |
| Tabela 18: Degët e bujqësisë me të cilat merren të anketuarit | 40 |
| Tabela 19 : Ndikimi i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të zones..... | 41 |
| Tabela 20: Të ardhurat mujore të të anketuarve | 41 |
| Tabela 21: Të ardhurat vjetore nga institucionet publike | 42 |
| Tabela 22: Të ardhurat vjetore nga institucionet private | 44 |
| Tabela 23: Të ardhurat vjetore nga bujqësia | 45 |
| Tabela 24: Të ardhurat vjetore nga pensionet | 47 |
| Tabela 25: Të ardhurat vjetore nga ndihmat sociale..... | 48 |
| Tabela 26: Të ardhurat vjetore nga remitencat | 49 |
| Tabela 27: Të ardhurat aktuale janë të mjaftueshme, apo jo | 50 |

| | |
|---|----|
| Tabela 28: Beneficionet sociale..... | 51 |
| Tabela 29: Përbushja e kërkesave të jetës nga beneficionet sociale..... | 51 |
| Tabela 30: Pjesmarrja në strukturat udhëheqëse | 52 |
| Tabela 31: Roli i shtetit në zhvillimin ekonomik të zonave rurale..... | 52 |
| Tabela 32: Destinimi i të ardhurave | 53 |
| Tabela 33: Pranimi i remitencave..... | 54 |
| Tabela 34: Sa here pranohen remitenca brenda një viti..... | 54 |
| Tabela 35: Forma e pranimi të remitencave | 55 |
| Tabela 36: Mënyra e përdorimit të remitencave..... | 55 |
| Tabela 37: Testi Chi-Square për variablat: arsimimi dhe punësimi | 57 |
| Tabela 38: Testi Chi-Square për variablat: profesioni dhe gjinia..... | 58 |
| Tabela 39: Korrelacioni ndërmjet të ardhurave vjetore dhe remitancave | 59 |
| Tabela 40: Testi Chi-Square për variablat: Mbulimi i shpënzimëve dhe punësimi | 60 |

Lista e grafikëve

| | |
|--|----|
| Grafiku 1. Puna Bujqësore (NjPV) dhe numri i punëtorëve sipas llojit të fuqisë punëtore bujqësore..... | 14 |
| Grafiku 2: Pjesmarrja e të anketuarve sipas profesioneve | 34 |

KAPITULLI 1

1. HYRJE

Mbrojtja e mjedisit, bujqësia dhe zhvillimi rural janë sektorë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, prandaj kurrësi nuk guxon të neglizhohet ndikimi i bujqësisë në mjedisin jetësor që na rrethon. Masat të cilat njeriu i realizon me qëllim të intensifikimit të prodhimit bujqësor kanë ndikime edhe pozitive edhe negative në agrosistem. Prandaj, qëllimi është të prodhohet ushqim cilësor, por edhe të kursehen resurset dhe energjia, të mbrohet mjedisi, të sigurohet efikasitet ekonomik dhe avancohet jetesa e bujqve dhe komunitetit në përgjithësi.

Më shumë se gjysma e territorit të Kosovës është e mbuluar me tokë bujqësore, ndërsa përqindja e popullatës që jeton në viset rurale arrin në mbi 60%. Bujqësia gjithashtu konsiderohet si një nga sektorët më kyç për zhvillim, si nga ana e autoriteteve lokale e qendrore ashtu edhe nga ana e donatorëve ndërkombëtarë. Mjetet që investohen në zhvillim të bujqësisë rriten nga viti në vit. Në krahasim me vitin 2007, kur nga buxheti i Qeverisë së Kosovës janë ndarë rreth 6 milionë euro, i njëjti në vitin 2013 ka arritur 31 milionë euro. Trend pozitiv ekziston edhe kur flitet për mjetet e donatorëve ndërkombëtarë, duke qenë se në vitin 2007 janë investuar 300,000 euro, në vitin 2013 janë investuar 3 milionë, ndërsa në vitin 2015 janë ndarë 11 milionë euro (lokalnirazvoj.org/, Maj 2017).

Viteve të kaluara në Kosovë janë hartuar disa dokumente strategjike nga fusha e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Gjithashtu, janë hartuar strategji dhe plane veprimi nga fusha e mjedisit, të cilat janë ngushtë të ndërlidhura me sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në diagramin e mëposhtëm janë paraqitur dokumentet më të rëndësishme strategjike për periudhën 2007-2024 (lokalnirazvoj.org/, Maj 2017).

Për disa vite, zhvillimi në viset rurale është menduar të jetë lidhur me bujqësinë dhe më saktësisht lidhur me prodhimin e produkteve bujqësore. Ndryshimi ka ndodhur në fillim të viteve

të 80-ta kur u bë e qartë për gjithnjë e më shumë njerëz që zhvillimi rural nuk nënkupton vetëm bujqësinë: koncepti i “ jetës rurale” ishte në shfaqje e sipër. Dhe vërtetë, jeta e fermerit nuk kufizohet vetëm në bujqësi por përfshin edhe shkollat për fëmijë, rrugët lokale, shërbimet shëndetësore dhe shërbimet tjera publike të nevojshme, etj (Novëbërdës, 2009). Pra, vetëm orientimi në zhvillimin e bujqësisë nuk mund të rezultojë me zhvillim të qëndrueshëm rural. Një konstatim i tillë është aktual sidomos për Kosovën, duke marrë parasysh nivelin e varfërisë dhe të papunësisë rurale, sipërfaqet e vogla të tokës së punueshme për një familje rurale, faktorët limitues për zhvillimin e një prodhimi konkurrues bujqësor në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, afërsinë e fshatrave me qendrat dhe qytetet më të mëdha në Kosovë (Nura, 2004). . Kështu teksa bujqësia është një aktivitet në rënie (të paktën në terma sasiorë), në shumë vende turizmi rural, strehimi, sportet dhe aktivitetet rurale janë shndërruar në elementë kyç të një ekonomie rurale (IDM, 2010).

Në Kosovë zhvillimi rural përballet me shumë probleme specifike; standardi i ulët, papunësia e madhe e popullsisë rurale, shkalla e ulët e arsimimit në zonat rurale, infrastruktura e dobët, niveli i ulët i prodhimit bujqësor dhe rritja e ngadalshme ekonomike me një bazë të gjerë (Nura, 2004). Të gjitha këto paraqesin sfida për arritjen e objektivit për zbutjen e diferencave zhvillimore ndërmjet zonave rurale dhe urbane, si dhe për zvogëlimin e varfërisë rurale nëpërmjet rritjes së mundësive dhe shansave të popullsisë rurale për të pasur qasje dhe për të marrë pjesë në aktivitete që gjenerojnë të ardhura dhe i kontribuojnë zhvillimit të vendit (RIINVEST, 2004).

Në këto rrethana zgjidhja është parë në diversifikimin e aktiviteteve të cilat sjellin të ardhura më të larta për banorët e zonave rurale, duke ndikuar kështu në rritjen e standardit jetësor dhe mirëqenies së tyre.

1.1.1.Rrugëtimi drejt BE-së

Disa prej sektorëve më të vështirë në kuptim të harmonizimit të dispozitave ligjore me ato të BE-së janë bujqësia dhe mjedisi, për shkak se për harmonizimin e tyre me dispozitat e BE-së kërkohen investime të cilat tejkalojnë mundësitë e Qeverisë së Kosovës.

Fillimi i këtij procesi është përshkruar me probleme të theksuara në kuptim të zbatimit të ligjeve, rregulloreve dhe akteve tjera. Gjithashtu është i theksuar problemi i miratimit të akteve ligjore duke përshkruar rregullativën ligjore nga vendet tjera të BE-së, të cilat shpesh nuk përkojnë me sistemin juridik të Kosovës, gjë që pamundëson implementimin e tyre. Përveç kësaj, është e domosdoshme edhe një administratë e fuqishme e cila ka kapacitete për implementim të politikave publike, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Mungon edhe praktika e nxjerrjes së politikave publike në bazë të fakteve, si dhe analiza e efekteve të dispozitave ekzistuese. Në kontekst të përafrimit me rrjedhat ligjore në BE në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në imazhet e mëposhtme janë paraqitur niveli i gatishmërisë dhe niveli i zhvillimit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor në procesin e integritimit në BE, në bazë të kritereve të përcaktuara në raportet e progresit për secilin shtet kandidat individualisht (lokalnirazvoj.org/, Maj 2017).

PPB luan rol të rëndësishëm për zhvillimin e politikave agrobujqësore në Kosovë në kuptim të rrugëtimit të saj drejt BE-së, prandaj ajo duhet të miratojë një sërë rregullash dhe rregulloresh obligative të rëndësishme për funksionimin e kësaj politike. Caku kryesor i PPB është sigurimi i një standardi jetësor për bujqit, si dhe furnizimi i sigurt dhe stabil i ushqimit, me çmime të përballueshme për të gjithë konsumatorët. Kjo sigurohet përmes ofrimit të përkrahjes për bujqit, promovimit të zhvillimit rural, avancimit të produktivitetit dhe kualitetit të jetës së njerëzve në vise rurale.

Duke qenë se Kosova është e pasur me tokë bujqësore, kjo politikë mund të përbëjë rast të mirë për zhvillimin e bujqësisë, fshatrave dhe viseve rurale në të ardhmen. PPB gjithashtu ka rol të theksuar për viset tjera, siç janë mbrojtja e mjedisit, siguria e kafshëve dhe mbrojtja e resurseve natyrore. Me rregullat e PPB sigurohet respektimi i parimeve të mbrojtjes së mjedisit, ndërsa me masat përkatëse të kësaj politike promovohen praktikat bujqësore të qëndrueshme nga këndvështrimi ekologjik (lokalnirazvoj.org/, Maj 2017).

1.1.2.Përmisimi i standartit të jetesës së popullatës rurale

Në PZHRB 2007-13 janë ofruar të dhënat që kanë treguar se zonat rurale të Kosovës, janë më të varfra se sa zonat urbane të saj. Të ardhurat nga bujqësia janë diku rreth 10% e të ardhurave të

përgjithshme të familjeve rurale. Shumica e të ardhurave për familjet rurale, vjen nga anëtarët e familjes që janë të punësuar dhe marrin paga, të cilat plotësohen me të ardhurat nga anëtarët e familjes që punojnë jashtë vendit. Derisa familjet rurale dhe urbane, kanë të njëjtat karakteristika, që të ardhurat nga jashtë vendit dhe asistenca nga të afërmit brenda Kosovës janë të rëndësishme, dallimi është se e gjithë përkrahja është më e lartë në zonat rurale, me përjashtim të të ardhurave jobujqësore dhe pagave. (mbpzhr-ks.net, 2010)


Mundësitë më të mira të punësimit, ofrojnë të ardhura më të larta për familjet urbane, krahasuar me ato rurale. Fermat e vogla në sektorin tradicional nuk përmbushin shumicën e nevojave familjare. Është vlerësuar që familjet rurale, plotësojnë vetëm 70% të nevojave të tyre familjare nga prodhimtaria bujqësore. Të dhënat sugjerojnë që rreth 75% të familjeve rurale shpenzojnë më pak se 300 euro për muaj, duke reflektuar një nivel më të lartë të varfërisë në zonat rurale krahasuar me zonat urbane. (mbpzhr-ks.net, 2010)

1.1.3.Fuqia punëtore në bujqësi

Të dhënat rreth fuqisë punëtore në bujqësi janë të rëndësishme për të vlerësuar se deri në çfarë mase bujqësia mund të absorbojë fuqinë punëtore rurale dhe shkallën deri në cilën punët jobujqësore kërkohen në viset rurale. Kjo e fundit tregon që politikat përtej bujqësisë, të cilat synojnë zhvillimin rural janë të domosdoshme. Gjatë anketës janë grumbulluar informata rreth punësimit të anëtarëve të familjeve në bujqësi, rreth përkushtimit të tyre në bujqësi, me orar të plotë apo të kohëpaskohshëm.

Puna bujqësore gjatë vitit 2019 e shprehur në njësi të punës vjetore (1 NjPV është e barabartë me 1 800 orë punë në vit). Sipas AEB 2019 puna bujqësore arrin gjithsej në 82 657 NjPV. Në strukturën e punës bujqësore, subjektet juridike përfaqësojnë vetëm 3.2% të NjPV-së (ASK, Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2020).

Grafiku 1. Puna Bujqësore (NjPV) dhe numri i punëtoreve sipas llojit të fuqisë punëtore bujqësore



Burimi: (ASK, Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2020).

Sipas grafikut 1 struktura e punës bujqësore në EB, vërehet se pjesën më të madhe si të numrit të personave të punësuar në EB ashtu edhe të punës bujqësore shprehur në NjPV dominon bartësi dhe anëtarët e tjerë të familjes.

1.1.4. Prodhimtaria Organike në Kosovë

Bujqësia organike është një nga segmentet që po tregon rritje në sektorin bujqësor të Kosovës. Interesi i fermerëve dhe konsumatorëve për produktet organike është rritur në vitet e fundit, për shkak të programeve të ndryshme mbështetëse publike dhe private (mbpzhr-ks.net, 2010).

Kosova është një vend i njohur për produktet pyjore jo-drusore, përfshirë këtu kërpudhat, frutat e imëta të pyjeve dhe bimët aromatike të egra. Sipas studimit, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, 2013 nga GIZ dhe CARE ndërkombëtare, Kosova ka një avantazh në këtë treg, pasi cilësia dhe shumëllojshmëria e produkteve pyjore jo-drusore kanë një reputacion të mirë ndërkombëtarisht. Gjithashtu një kontribut tjetër është forca e lirë e punës, në lidhje me mbledhjen, kultivimin dhe përpunimin e këtyre produkteve (mbpzhr-ks.net, 2010).

Sipas raportit vjetor të vitit 2012 nga Ministria e Bujqësisë, Pyllit dhe Zhvillimit Rural, pjesëmarrja e produkteve pyjore jo-drusore në Industrinë e Agrobiznesit vlerësohet të jetë më pak se 10%. Prandaj, vlera totale në tregun e produkteve pyjore jo-drusore është rreth 10 milion euro në vit. Kompanitë aktive që veprojnë nën këtë sektor në tregun e Kosovës, janë rreth 13, të cilat kanë një qarkullim vjetor nga 50,000 - 2,500,000 Euro. Edhe pse shumica e këtyre ndërmarrjeve shesin më pak se 100 tonë në vit, një numër i vogël i kompanive kryesore tregtojnë më shumë se 200 tonë kërpudha dhe produkte të tjera pyjore jo-drusore në vit, duke kryer një qarkullim vjetor prej më shumë se 1.000.000 euro (mbpzhr-ks.net, 2010).

Shumica e produkteve pyjore jo-drusore përfundojnë të eksportohen, në tregun e BE, veçanërisht në Itali dhe Gjermani si produkte të përpunuara; kështu që vetëm 5% e këtyre produkteve përfundojnë të shiten brenda tregut të Kosovës. Aktualisht në Kosovë, fermerët dhe fshatarët nga zonat rurale mbledhin produkte pyjore jo-drusore në malet e Kosovës. Këto zona të mundshme për mbledhjen e këtyre produkteve janë mbi 100,000 hektarë, edhe pse aktualisht vetëm 25% e kësaj zone po përdoret për mbledhjen e këtyre produkteve.

Një hulumtim tjetër i zbatuar nga HPK në bashkëpunim me GIZ, rezultoi se Kosova ka potencial për 28,000 ton për 85 specie të identifikuar në pesë (5) rajone të ndryshme të Kosovës. Sipas këtij studimi, aktualisht vetëm 6% e këtij potenciali po përdoret, në thelb, produkte pyjore jo-drusore si: Boronicat, Dëllinjat, Kërpudhat dhe disa bimë të tjera aromatike (mbpzhr-ks.net, 2010).

Toka pjellore, kushtet e favorshme agro-klimatike, korniza ekzistuese e politikave dhe njohuritë tradicionale të fermerëve lokal janë një bazë e mirë për zhvillimin e bujqësisë organike. Në Kosovë, sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) si në kultivim ashtu edhe në grumbullim të produkteve pyjore jo drusore (PPJD) është mjaft i konsoliduar.

Tabela 1. Te dhënat e BMA-t për vitin 2019

| Viti 2019 | |
|--------------------------------|------------|
| Te kultivuara | 480 ha |
| Kompani te certifikuara | 35 kompani |
| Zona te certifikuara | 373,488 ha |
| Qendra te grumbullimit | 45 qendra |

Burim: (mbpzhr-ks.net, 2010)

Në tabelen 1 janë të paraqitura të dhënat për vitin 2019 që tregojnë se janë gjithsej 480 ha të kultivuara me bimë mjekësore de aromatike, 35 kompani të certifikuara, 373,488 ha zona të certifikuara për grumbullim të bimëve mjekësore dhe frutave të egra dhe 45 qendra të grumbullimit në tërë Kosovën. Gjithashtu janë 522.47 ha të kultivuar me kunguj për prodhimin e farave/prodhim të vajit organik dhe 34.07 ha të kultivuara me arra (mbpzhr-ks.net, 2010).

Bimët mjekësore aromatike (BMA) dhe pemët frutore të egra (PFE) janë përdorë nga kohët e lashta dhe edhe sot përdoren në mjekësinë tradicionale nga popujt e ndryshëm, por shumë nga këto bimë sot janë hulumtuar në aspektin shkencor dhe ato janë përbërësit kryesorë të shumë ilaçeve që prodhohen nga kompanitë e ndryshme botërore farmaceutike. Edhe në Republikën e Kosovës rriten rreth 300 lloje të BMA dhe PFE, që paraqesin një resurs të rëndësishëm kombëtar dhe për këtë arsye ato duhet të ruhen dhe të çmohen si të tilla (S4RE, 2015).

Grumbulluesit e BMA dhe PFE duhet të punojnë në përputhje me standardet e përgjithshme që kërkohen nga BE. Për të arritur këto standarde grumbulluesit duhet të kenë njohuri të

përgjithshme për BMA dhe PFE, duhet të njohin BMA dhe PFE, teknikat e vjeljes, të transportit, të tharjes, staxhionimit dhe paketimit, rregullat kryesore për grumbullim të qëndrueshëm të BMA dhe PFE (S4RE, 2015).

Vendi ynë është i pasur me lloje të ndryshme të bimëve mjekësore, që, në shikim të parë, për shumë njerëz, është një informatë e panjohur. Por me kalimin e kohës njërëz janë duke i mësuar vlerat e BMA-ve dhe ka shumë fermer që janë të interesuar dhe i mbjellin ato. Më poshte në tabelën 2 shohim se sa prej të anketuarve marrin me BMA.

1.2. Sfondi i studimit dhe problemi

Karakteristikat që e dallojnë strukturën e të ardhurave të familjeve rurale me ato urbane janë të ardhurat nga bujqësia, remitancat nga jashtë dhe asistencat nga të afermit në Kosovë. Të gjitha këto burime të të ardhurave janë më të larta të familjet rurale. Ndërsa të ardhurat nga biznesi dhe pagat e të punësuarve janë më të larta të familjet urbane (Riinvest, 2013).

Mirëqenia sociale e banorëve të zonës rurale mbetet ende një ndër problemet kryesore me të cilat ballafaqohet vendi ynë. Banorët e këtyre zonave përballen më mungesë të të hyrave dhe mundësi të kufizuara për rritjen e burimeve shtesë. Prandaj është e nevojshme që të gjinden rrugë për rritjen e këtyre burimeve përmes aktiviteteve dhe shërbimeve të ndryshme që mundësojnë çasje në lloje të ndryshme të të hyrave.

Të banorët e zonave rurale ka problem në shpërndarjen e të hyrave, pra mirëqenia nuk është e njëjtë. Ndodh kështu se disa banorë kanë mundësi më të shumta sepse rrethanat e tyre të jetës ju kanë mundësuar të përfitojnë lloje të ndryshme të hyrash dhe natyrshëm mirëqenia e tyre është më e mirë krahasuar me pjesën tjetër që kanë mundësi të kufizuara dhe mbështetjen në burime të pakta të të hyrave dhe përballen më varferi dhe situata të vështira.

Ky punim paraqet një çështje të veçantë sa i përket zonës rurale, zhvillimit ekonomik të saj, të hyrave të diversifikuara të banorëve të kësaj zone. Por shpresojmë se ky studim mund të jetë një udhërrëfyes i dobishëm rreth asaj që duhet bërë për komunitetet rurale në përgjithësi.

1.3. Objektivi kryesorë dhe objektivat specifik të punimit

Qëllimi i studimit ka për synim që të ofrojë një pasqyrë lidhur me atë se si ndikon diversifikimi i të hyrave në mirëqenien sociale të banorëve të zonave rurale në Regjionin e Mitrovices.

Duke marrë parasysh këtë studimi do të bazohet në një objektiv të përgjithshëm dhe disa objektive specifike, si më poshtë:

- **Objektivë i përgjithshëm:**

Vlerësimi i ndikimit të diversifikimit të të hyrave në mirëqenien sociale të banorëve të zonave Rurale.

- **Objektivat specifik**

- a) Përcaktimi i llojeve të të ardhurave që kanë ndikim më të madh në mirëqenien sociale
- b) Të përcaktohet roli i sektorit bujqësor në rritjen e të ardhurave.
- c) Cili është roli i remitencave në rritjen e mirëqenies së familjes?
- d) Të përcaktohen faktoret dhe motivet që i shtyjnë familjet në diversifikim të të ardhurave?

1.4. Pyetjet dhe hipotezat hulumtuese

Secili nga objektivet specifik përcillet me një apo më tepër pyetje hulumtuese të cilat janë si vijon:

- **Objektivë specifikë:**

- a) Të përcaktohen faktoret dhe motivet që i shtyjnë familjet në diversifikim të të hyrave?

Pyetjet hulumtuese:

1. Pse familjet diversifikojnë të hyrat?
2. Cilat janë asyet që i shtyjnë familjet drejt diversifikimit të të hyrave?

- **Objektivë specifikë:**

b) Përcaktimi i llojeve të të hyrave që kanë ndikim më të madh në mirëqenien sociale

Pyetjet hulumtuese:

1. Cilat janë burimet kryesore të të ardhurave në familje?
2. Sa janë të ardhurat aktuale në familje?
3. Cilat aktivitete krijojnë të ardhura më të larta?

- **Objektivë specifikë:**

c) Të përcaktohet roli i sektorit bujqësor në rritjen e të ardhurave

Pyetjet hulumtuese:

2. Cilat janë të ardhurat nga bujqësia?
3. A është bujqësia aktiviteti kryesor i gjenerimit të të ardhurave në familje?

Hipotezat e studimit

Ky studim do të bazohet në testimin e këtyre hipotezave:

1.

HO: Diversifikimi i të ardhurave nuk ndikon në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

H1: Diversifikimi i të ardhurave ndikon në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

2.

HO: Aktivitetet me karakter jobujqësor japin kontribut të ulët në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

H1: Aktivitetet me karakter jobujqësor japin kontribut më të madh në mirëqenien e banorëve të zonave rurale.

3.

HO: Aktivitetet me karakter bujqësor japin kontribut të ulët në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

H1: Aktivitetet me karakter bujqësor japin kontribut më të madh në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

4.

HO: Remitenat nuk ndikojnë në mirëqenien e banorëve të zonave rurale

H1: Remitenat ndikojnë në mirëqenien e banorëve të zonave rural.

KAPITULLI 2

2. Rishikimi mbi literaturën e fushës

Diversifikimi është një koncept themelor në një larmi fushash, të tilla si ekonomia financiare, vendimmarrja, sociologjia, teoria e konsumit, rritja ekonomike, gjenetika dhe evolucioni (Mahmoud, 2017). Historikisht, diversifikimi është ndjekur me qëllim që të zvogëlohet rreziku i mbështetjes në vetëm një ose disa burime të ardhurash, dhe ndonjëherë është rruga e vetme për rritje më të shpejtë (MBN).

„Mos i vendosni të gjitha vezët tuaja në një shport ” Kjo thënie popullore është ideja thelbësore prapa diversifikimit: ju nuk doni të humbni shumicën e vezëve tuaja nëse shporta juaj ju përmbys. Kur bëhet fjalë për një strategji investimi, diversifikimi mund të duket pak më i komplikuar se sa mençuria e dashur, por ideja është e njëjta (Hull, 2020).

Ekonomia merret më anen ekonomike të jetës së një shoqërie. Ajo hulumton sjelljet e individëve dhe ndermarrjeve, prodhuesve, konsumatorve dhe qeverisë. Objekt i ekonomisë është pasuria që përbëhet nga të gjitha mallrat dhe shërbimet por edhe mirëqenia që shpreh dobin apo kënaqësin që individët apo shoqëria nxjerr nga shfrytëzimi i pasurisë apo produkteve dhe shërbimeve të cilat i ka ajo shoqëri (Jakupi, A.& Mustafa,I., 2010). Ekonomia merret më të gjitha fazat e prodhimit të mirave si prodhimi, shpërndarja, kembimi dhe konsumi (Limani, 2011).

Toka përfshin të gjitha burimet natyrore dhe minerale që gjenden në dhe nën sipërfaqen e saj, pyjet dhe të mbjellurat tjera. Puna përmban të gjitha llojet e burimeve njerzore si sipërmarrsit, që

janë individ që krijojnë mundësi prodhimi fitimprurës, toka me begatin e saj është kusht i përgjithshëm natyror, i domosdoshëm për prodhimin e të mirave materiale dhe shoqërisë njerzore në çdo formacion ekonomik-shoqëror (Bashota, 1998). Më kapital nënkuptojmë makinerit, fabrikat, ndërtesat dhe informacioni që shfrytëzohen për prodhim. Ndërsa deget kryesore të ekonomisë janë: bujqësia, industria, turizmi, tregtia, ndërtimtaria, komunikacioni (Jakupi, A. & Mustafa, I., 2010).

Ju duhet diversifikim për të minimizuar rrezikun e investimit. Nëse do të kishim njohuri të përsosura për të ardhmen, të gjithë mund të zgjidhnin thjesht një investim që do të performonte në mënyrë perfekte për aq kohë sa duhej. Meqenëse e ardhmja është shumë e pasigurt dhe tregjet gjithmonë ndryshojnë, ne i diversifikojmë investimet tona midis kompanive dhe aktiveve të ndryshme që nuk janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të njëjta.

Diversifikimi nuk është krijuar për të maksimizuar kthimet. Në çdo kohë të caktuar, investitorët të cilët përqendrojnë kapitalin në një numër të kufizuar investimesh mund të tejkalojnë një investitor të larmishëm. Me kalimin e kohës, një portofol i larmishëm në përgjithësi tejkalon shumicën e një më të përqendruari. Ky fakt nënvizon sfidat e përpjekjes për të zgjedhur vetëm disa investime fituese (Curry, 2021).


Një çelës për diversifikimin është zotërimi i investimeve që performojnë ndryshe në tregje të ngjashëm. Kur çmimet e aksioneve po rriten, për shembull, rendimentet e bonove zakonisht bien. Profesionistët do të thoshin se aksionet dhe obligacionet janë të lidhura negativisht. Edhe në momentet e rralla kur çmimet e aksioneve dhe rendimentet e obligacioneve lëvizin në të njëjtin drejtim (të dyja fitojnë ose humbasin të dyja), aksionet zakonisht kanë paqëndrueshmëri shumë më të madhe - që do të thotë se fitojnë ose humbin shumë më tepër sesa obligacionet.

Ndërsa jo çdo investim në një portofol të larmishëm do të jetë i ndërlidhur negativisht, qëllimi i diversifikimit është blerja e aseteve që nuk lëvizin në hap me njëra-tjetrën (Sultana, N., Hossain, E. & Islam, K., 2015).

3.1. Strategjia e diversifikimit

Ka shumë strategji të ndryshme të diversifikimit për të zgjedhur, por emëruesi i tyre i përbashkët është blerja e investimeve në një varg klasash të ndryshme të aseteve. Një klasë e aseteve nuk

është asgjë më shumë sesa një grup investimesh me karakteristika të ngjashme të rrezikut dhe kthimit. Strategjia e diversifikimit, siç e dimë tashmë, është një strategji e rritjes së biznesit të identifikuar nga një kompani që zhvillon produkte të reja në tregje të reja. Ky përkufizim na tregon se çfarë është strategjia e diversifikimit, por nuk ofron ndonjë pasqyrë të vlefshme pse është një strategji ideale e rritjes së biznesit për disa kompani ose si zbatohet. Strategjia e diversifikimit përcaktohet duke shtuar produkte të reja në tregje të reja (Curry, 2021).



Për shembull, aksionet janë një klasë e asetëve, siç janë edhe obligacionet. Aksionet mund të ndahen më tej në klasa të aktiveve të aksioneve me kapak të madh dhe aksione me kapak të vogël, ndërsa obligacionet mund të ndahen në klasa të asetëve si bono të shkallës së investimeve dhe bono junk (Curry, 2021).

3.2. Aksionet dhe obligacionet

Aksionet dhe obligacionet përfaqësojnë dy nga klasat kryesore të asetëve. Kur bëhet fjalë për diversifikimin, një nga vendimet kryesore që investitorët marrin është se sa kapital për të investuar në aksione vs bono. Vendimi për të ekuilibruar një portofol më shumë ndaj aksioneve vs obligacioneve rrit rritjen, me koston e paqëndrueshmërisë më të madhe. Bonot janë më pak të paqëndrueshme, por rritja në përgjithësi është më e zbutur.

Për investitorët e rinj në pension, zakonisht rekomandohet një alokim më i madh parash në stoqe, për shkak të performancës së tyre afatgjatë në krahasim me obligacionet. Si rezultat, një portofol tipik pensioni do të alokojë 70% deri 100% të aktiveve në aksione (Berger, 2021).

Ndërsa një investitor i afrohet pensionit, megjithatë, është e zakonshme të zhvendoset portofoli më shumë drejt obligacioneve. Ndërsa ky ndryshim do të zvogëlojë kthimin e pritur, ai gjithashtu

zvogëlon paqëndrueshmërinë e portofolit pasi një pensionist fillon të kthejë investimet e tyre në një listë page të pensionit (Sultana,N.,Hossain,E&Islam,K., 2015).

3.3. Diversifikimi me Fondet e Ndërsjella

Krijimi i një portofoli të larmishëm me fonde të përbashkëta është një proces i thjeshtë. Në të vërtetë, një investitor mund të krijojë një portofol të larmishëm me një fond të vetëm pensioni për një datë të synuar. Mund të krijohet një larmi e jashtëzakonshme me vetëm tre fonde indeksi në atë që njihet si portofoli i 3 fondeve.

Sidoqoftë mund të bëhet diversifikimi i një portofoli, ajo është një strategji e rëndësishme e menaxhimit të rrezikut. Duke mos vendosur të gjitha vezët tuaja në një shportë, ju zvogëloni paqëndrueshmërinë e portofolit ndërsa nuk sakrifikoni kthime të konsiderueshme të tregut (Berger, 2021).

3.4. Diversifikimi mund të jetë i dobishëm edhe kur rezervat po rriten.

Rritjet e mëdha të një sektori, ose të tregut në tërësi, shpesh mund të drejtohen nga disa fitues të mëdhenj. Meqenëse askush nuk mund të jetë i sigurt se cilat stoqe ose industri do të udhëheqin rritjen tjetër, një portofol i larmishëm mund të rrisë shumë mundësinë që të merrni një pjesë të fitimeve. Diversifikimi gjithashtu mund t'ju ndihmojë të përfitoni nga aksionet që janë përkohësisht në rënie përmes ribalancimit, të përcaktuara më poshtë (Schwarze, 2005).

Saktësisht se si e diversifikoni portofolin tuaj do të ndryshojë në varësi të hulumtimit tuaj, nivelit tuaj të rrezikut të pranueshëm, afatit tuaj të investimeve dhe strategjisë tuaj të përgjithshme të investimeve. Sidoqoftë që vendosni të diversifikoni, ka metoda dhe mjete për t'ju ndihmuar të mbani portofolin tuaj në rrugën e duhur me strategjinë tuaj të diversifikimit (Hull, 2020).

3.5. Pse kompanitë diversifikojnë?

E para dhe më e rëndësishmja, kompanitë diversifikojnë për të arritur një përfitim më të madh. Diversifikimi përdoret nga bizneset për t'i ndihmuar ata të zgjerohen në tregje dhe industri që nuk i kanë hulumtuar aktualisht. Kjo arrihet duke shtuar produkte, shërbime ose karakteristika të reja që do t'u pëlqejnë klientëve në këto tregje të reja.

Duke zgjeruar shtrirjen dhe tërheqjen e tyre, bizneset janë në gjendje të eksplorojnë rrugë të reja për shitje, dhe nga ana tjetër, kanë potencialin për të rritur jashtëzakonisht fitimet e tyre. Përveç arritjes së përfitimit më të lartë, kompanitë zgjedhin të diversifikojnë për një larmi arsyesh të tjera. Për shembull, diversifikimi gjithashtu mund të lejojë një kompani të minimizojë rrezikun e një rënie të industrisë, ajo mund të rrisë imazhin e markës, dhe gjithashtu mund të përdoret si një mekanizëm mbrojtës për të mbrojtur një kompani nga konkurrenca e fortë (Madison, 2015).

I. Rreziqet e strategjisë së diversifikimit

Ndryshe nga strategjia e depërtimit në treg, strategjia e diversifikimit konsiderohet me rrezik të lartë jo vetëm për shkak të rreziqeve të qenësishme që lidhen me zhvillimin e produkteve të reja, por edhe për shkak të mungesës së përvojës së biznesit duke punuar brenda tregut të ri. Kur një kompani zgjedh të diversifikojë, ata me vetëdije e vendosin veten në një pozitë të pasigurisë së madhe. Për më tepër, diversifikimi shpesh kërkon zgjerim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore dhe financiare, të cilat nganjëherë mund të kenë një efekt të dëmshëm në shpërndarjen e burimeve në industrinë kryesore (lokalnirazvoj.org/, Maj 2017).

Për këto arsye, rekomandohet që një kompani duhet të ndjekë një strategji diversifikimi vetëm kur produkti aktual ose tregu aktual nuk ofron më mundësi për rritje të mëtejshme. Kritike që kompanitë të vlerësojnë plotësisht rreziqet dhe të vlerësojnë gjasat e arritjes së një rezultati fitimprurës para se të vendosin të ndjekin diversifikimin.

II. Lloje të ndryshme të strategjisë së diversifikimit

Në botën e biznesit, nuk ka zgjidhje "**një strategji i përshtatet të gjithëve**" për rritje. Diversifikimi mund të paraqitet në një larmi formash të ndryshme në varësi të drejtimit që një biznes dëshiron të lëvizë, dhe mund të jetë i lidhur ose pa lidhje me ofertën aktuale të biznesit.



Konglomeratit
Koncentrik
Horizontal
Vertikal

Diversifikimi horizontal

Nëse kompania juaj vendos të shtojë produkte ose shërbime që nuk kanë lidhje me atë që ju ofroni aktualisht, por mund të plotësojnë disa nevoja më shumë të klientëve tuaj ekzistues, kjo njihet si diversifikim horizontal. Diversifikimi horizontal është zakonisht strategjia e diversifikimit me rrezikun më të vogël të përfshirë, pasi jeni duke punuar kryesisht brenda segmenteve të njohura të klientit dhe tregut. Thoni se jeni CEO i Dunder Mifflin Paper Company - mund të ketë kuptim të plotë të kaloni në prodhimin e printerëve. Ky është një produkt krejt tjetër, por ka potencial për të tërhequr shumë nga klientët tuaj ekzistues (lightercapital).

Diversifikimi koncentrik

Diversifikimi koncentrik ndodh kur një kompani hyn në një treg të ri me një produkt të ri që është teknologjikisht i ngjashëm me produktet e tyre aktuale dhe për këtë arsye janë në gjendje të fitojnë disa avantazhe duke shfrytëzuar gjëra të tilla si përvojën e industrisë, njohuritë teknike dhe ndonjëherë edhe proceset e prodhimit tashmë të vendosura. Diversifikimi koncentrik mund të jetë i dobishëm nëse shitjet janë në rënie për një produkt, pasi humbja e të ardhurave mund të kompensohet nga një rritje e shitjeve nga produktet e tjera. Një shembull i diversifikimit koncentrik do të ishte një prodhues kompjuterash i cili diversifikoi nga kompjuterat desktop të ngathët në prodhimin e laptopëve. Kjo do t'i lejojë ata të përfitojnë menjëherë nga vala e re e përdoruesve të kompjuterëve që kërkuan zgjidhje më të lëvizshme (lightercapital).

Diversifikimi i konglomeratit

Nëse po kërkoni të diversifikoheni në tregje krejtësisht të reja me produkte të palidhura për të arritur baza krejt të reja konsumatorësh, kjo njihet si diversifikim i konglomeratit. Termi

konglomerat i referohet një grupi të vetëm të korporatave që operojnë subjekte të shumta biznesi brenda industrive krejtësisht të ndryshme. Kompania mëmë që zotëron të gjitha entitetet individuale njihet si një konglomerat dhe u bë një duke zbatuar me sukses një strategji të diversifikimit të konglomeratit. Një shembull i diversifikimit të konglomeratit do të ishte Tata Group, i cili u themelua në 1868 dhe u diversifikua nga fillimet e tij modeste si një kompani hoteliere në një shumëkombëshe globale që përfshin 100 kompani individuale. Tani punëson 706,000 njerëz në një larmi sektorësh si kimikate, çelik, automobilizëm, inxhinieri, telekomunikacion, sisteme informacioni dhe materiale konsumuese (lightercapital).

Diversifikimi vertikal

Diversifikimi vertikal njihet gjithashtu si integrim vertikal dhe ndodh kur një kompani lëviz lart ose poshtë në zinxhirin e furnizimit duke kombinuar dy ose më shumë faza të prodhimit të operuara normalisht nga kompani të veçanta. Kjo zakonisht do të thotë që kompania vendos të fillojë të marrë përsipër disa ose të gjitha funksionet që lidhen me prodhimin dhe shpërndarjen e produktit të tyre kryesor, siç janë blerja e lëndës së parë, proceset e prodhimit, montimi, shpërndarja dhe shitja. Për shembull, Nëse jeni shitës me pakicë, diversifikimi vertikal mund të nënkuptojë lëvizjen në prodhimin e produkteve që shesni aktualisht. Ndërsa kjo mund të ndihmojë në uljen e kostove duke mbuluar të gjitha nevojat e biznesit tuaj "brenda", e keqja është se mund të zvogëlojë fleksibilitetin e biznesit tuaj dhe të zvogëlojë mundësinë për diversifikim horizontal në të ardhmen (lightercapital).

Ekzistojnë dy forma të diversifikimit vertikal, të cilat identifikohen nga drejtimi që lëvizni në zinxhirin e furnizimit.

Tabela 2. Format e diversifikimit

| 1. Diversifikimi përpara | 2. Diversifikimi i prapambetur |
|--|---|
| <p>Nëse jeni në fillim të një zinxhiri furnizimi për sa i përket pozicionimit të biznesit tuaj, mund të vendosni që dëshironi të kontrolloni operacionet edhe më tej përgjatë zinxhirit. Një shembull i kësaj mund të jetë një kompani minerare që vendos se dëshiron të zgjerohet në përpunimin dhe zhvillimin e produktit të saj të papërpunuar.</p> | <p>Nëse jeni më afër fundit të një zinxhiri furnizimi, mund të mendoni se si të diversifikoheni në tregjet që hyjnë në produktin tuaj. Për shembull, Netflix filloi si një platformë e shpërndarjes mediatike, por tani prodhon vetë përmbajtjen e saj.</p> |

Burimi: (lightercapital).

2.6. Të hyrat brenda Kosovës

Qeveritë e Kosovës që nga pas lufta, përveç në segmentet e tjera shtetërore e shoqërore, edhe në zhvillimin e politikës fiskale kanë bërë reforma rrënjësore, të cilat kanë ndikuar në formimin e të hyrave, janë angazhuar në ndërtimin e sistemit tatimor e të instrumenteve të tjera, të cilat janë në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë makro-fiskale të vendit. Kosova tashmë ka ndërtuar një sistem të shëndoshë, stabil dhe konkurrent tatimor, i cili ka mundësuar që nga viti në vit të rrisë të ardhurat nga tatimet e ndryshme.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2009, Qeveria e Kosovës implementoi reformën tatimore, e cila është fokusuar në uljen e normave tatimore që ka rezultuar në ruajtjen dhe ngritjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave jo vetëm përmes instrumenteve që funksionojnë, por edhe përmes fuqizimit të dy institucioneve përgjegjëse për mbledhjen, përkatësisht grumbullimin mjeteve të cilat formojnë të ardhurat apo të hyrat publike: **Administrata Tatimore dhe Dogana.**

Si rezultat i funksionimit të sistemit të tatimeve, marrë në përgjithësi, në Republikën e Kosovës sistemi i të ardhurave apo të hyrave buxhetore është i përbërë prej katër llojeve: të hyrat nga tatimet, të hyrat jotatimore, dividenda dhe të hyrat nga donatorët (Kryeziu, 2015).

Table 3. Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë në (%).

| Viti | 2016 |
|---|------|
| Burimi i të hyrave | (%) |
| Rrogat nga sektori publik | 25 |
| Rrogat nga sektori privat | 26 |
| Bujqësi | 5 |
| Të ardhura nga medijtja | 7 |
| Biznese të tjera të ekonomive familjare | 11 |
| Pensionet | 11 |
| Dergimi i parave nga jashtë | 8 |
| Të hollat e dërguara nga Kosova | 1 |
| Ndimë sociale | 4 |
| Të ardhurat nga prona | 0 |
| Pensionet e familjeve të dëshmorëve | 1 |
| Të tjera | 1 |
| Totali | 100% |

Burimi: (ASK, Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2020).

Nga tabela 6 vërehet se burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë janë pagat, pastaj bizneset, pensionet e kështu me rradhë.

Por ajo që vlen të theksohet është se dërgesat nga jashtë apo remitencat janë burimi i pestë më i madh për një pjesë të ekonomive familjare, ku një nga dhjetë familje jetojnë nga paratë e dërguara nga jashtë. Duke i analizuar burimet e tjera të të ardhurave duke përjashtuar remitencat, shohim se familjet që nuk pranojnë remitenca sigurojnë pjesën më të madhe të buxhetit nga punësimi për dallim nga ato familje që janë pranuese (UNDP, 2012).

Ekonomitë familjare jopranuese sigurojnë 82% të hyrave të tyre nga një formë e punësimit (i përhershëm, përkohëshëm, vetëpunësim, punësim sezonal), ndërsa familjet pranuese sigurojnë 68% të të hyrave të tyre nga këto aktivitete. Ekonomitë familjare pranuese të remitencave shpenzojnë 66 euro më shumë në muaj se ekonomitë jo-pranuese (UNDP, 2012). Më poshtë po paraqesim burimet e të hyrave individuale në Kosovë.

Table 4. Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2016

| Burimi i të hyrave | Viti 2016 shprehur në % |
|---|-------------------------|
| -Neto rrogat dhe pagesat fituara në Kosovë në sektorin publik | 28 |
| -Neto rrogat dhe pagesat fituara në Kosovë në sektorin privat | 23 |
| -Pagat në natyrë | 4 |
| -Të ardhurat nga mëditjet | 1 |
| -Qiraja, dividendë, interesi (nga kursimi në bankë) | 2 |
| -Benefitet për mirëqenie sociale | 8 |
| -Pensionet nga Kosova | 4 |
| -Pensionet nga jashtë Kosovës | 11 |
| -Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë | 2 |
| -Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët (pagat, transferet, etj) | 5 |
| -Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera | 11 |
| -Të hyrat nga bujqësia | 1 |
| Totali në % | 100 |
| Totali në milion € | 1.996 |

Burimi: (ASK, Anketa e Ekonomive Bujqësore, 2020).

Nga të dhënat e tabelës 4 vërehet se burimi kryesor i të hyrave individuale në Kosovë janë pagat, pastaj bizneset, pensionet e kështu me rradhë.

KAPITULLI 3

4. Metodologjia e aplikuar

Zgjedhja e një metodologjie ose filozofie kërkimi është një shqetësim kryesor kur vendoset për të bërë një projekt kërkimor. Identifikimi i metodologjisë së hulumtimit ofron një larmi metodash dhe qasjesh për t'u përdorur, pavarësisht nga kufizimet që mund t'i imponohen kërkimit.

Përzgjedhja e metodave dhe metodologjive do të bëhet në përputhje me natyrën e studimit si dhe me llojin e të dhënave.


Rjedhja e studimit do të jetë e ndarë në dy pjesë, pjesën teorike ku do të përdorim të dhënat sekondare që përfshijnë të dhëna të publikuara dhe analizuara më parë nga literatura të ndryshme cofshin vendore apo edhe të huaja, raporte dhe publikime të tjera lidhur me temën, si dhe pjesën praktike ku do të përdoren të dhënat parësore që përfshijnë mbledhjen e të dhënave nga terreni.

Pra metodologjia e studimit përbëhet nga tërësia e metodave kualitative dhe kuantitative realizuar me anë të një pyetesori si instrument për mbledhjen e të dhënave nga informatorët i strukturuar dhe i përshtatur me rrethanat e intervistimit, njohurive, aftësive, eksperiencës e në veqanti me nivelin e botëkuptimeve të të intervistuarve.

Pyetesori i tillë do të përdoret për intervistimin e 100 familjeve rurale në Regjionin e Mitrovicës, ku janë të përfshira tri Komuna atë të Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrris. Duke përdorur indikator socio-ekonomik për të vlerësuar se si ndikojnë llojet e ndryshme të të hyrave në mirëqenien e banorëve të zonave rurale, ku në fokus do të jenë të ardhurat e karakterit bujqësor, jobujqësor.

Të dhënat e grumbulluara do të analizohen dhe do të përpunohen me anë të programit statistikor SPSS ndërsa analizimi i rezultateve do të bëhet përmes metodës analitike dhe krahasues për të rezultuar në përfundime dhe rekomandime konkrete.

4.1. Të dhënat e përdorura



4.2. Metoda statistikore

Për të ardhur deri të rezultatet e këtij hulumtimi, së pari kemi bërë kodimin e pyetësorëve, pastaj është bërë vendosja e të dhënave në programin kompjuterik Microsoft Excel dhe më pastaj është bërë transferimi i të dhënave në programin SPSS (Statistical Package for Social Sciences). Në kuadër të metodologjisë së punës për hartimin e punimit jemi shërbyer me metodën e krahasimit, metodën përshkruese si dhe metodën e analizës statistikore. Të dhënat e fituara janë analizuar përmes softuerit statistikor SPSS dhe Microsoft Excel. Testimi i hipotezave të ngritura është bërë përmes korelacionit bivariante dhe Testit Chi-Square.

KAPITULLI 4

4.1. Rezultatet e hulumtimit

Rezultatet e paraqitura në këtë seksion përfshin rezultatet e 100 të anketuarve në 3 komuna atë të Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrris të gjeneruara me anë të programit statistikor SPSS.

Tabela 5: Pjesmarrja e respondentëve sipas gjinisë

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|-----------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Valid | Femer | 50 | 50.0 | 50.0 |
| | Mashkull | 50 | 50.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Pra, sa i përket moshës nga gjithsej 100 të anketuar të cilët ishin pjesë e këtij studimi 50 prej tyre apo 50.0 % i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 50 apo 50.0% i takojnë gjinisë mashkullore. Çka do të thotë se pjesa e respondentëve jo qëllimisht është marrë që të jetë e barabart.

Tabela 6: Pjesmarrja e respondentëve sipas moshes

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|--------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Vali d | 20-30 | 27 | 27.0 | 27.0 |
| | 31-50 | 44 | 44.0 | 71.0 |
| | 51-70 | 29 | 29.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Me qëllim studimi, të anketuarit i kemi ndarë në tri kategori. Nga rezultatet e fituara shohim se të anketuarit i takojnë moshës prej 20 deri në 70 vjeçare, ku 27 të anketuar apo 27.0% e të anketuarve i takojnë moshës 20-30 vjeç, 44 të anketuar apo 44.0% e tyre i takojnë kategorisë 31 deri në 50 vjeç, ndërsa 29 të anketuar apo 29.0% janë 51 deri në 70 vjeç.

Tabela 7: Shpërndarja e pyetësorit sipas komunave

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Vali d | Mitrovica | 31 | 31.0 | 31.0 |
| | Skenderaj | 41 | 41.0 | 72.0 |
| | Vushtrri | 28 | 28.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |


Si shihet edhe nga tabela e realizuar përmes programit statistikor SPSS, studimi jonë është shtrirë në 3 komuna, në komunën e Mitrovicës ku kanë qenë të anketuar 31 respondent, në komunën e Skenderajit kanë qenë 41 të anketuar, dhe në komunën e Vushtrris kanë qenë të anketuar 28 respondent. Pra gjithsej numri i përgjithshëm i pyetësorëve të realizuar është 100.

Tabela 8 : Pjesmarrja e respondentëve sipas kualifikimit profesional

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|------------------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Vali d | Shkolla fillore | 22 | 22.0 | 22.0 |
| | Shkolla e mesme | 33 | 33.0 | 55.0 |
| | Shkollimi universitar | 45 | 45.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Sa i përket kualifikimit profesional të të anketuarvë nga rezultatet e fituara shohim se pjesa më e madhe e tyre konkretisht 45 të anketuar apo 45.0% e tyre janë me kualifikim universitar, 33 prej tyre apo 33.0% janë me shkollim të mesëm, ndërsa 22 respondentë apo 22.0% e tyre nga të gjithë të përfshirët në studim janë me shkollim fillor.

Grafiku 2 : Pjesmarrja e të anketuarve sipas profesioneve



Nga 100 të anketuar kemi hasur në profesione të ndryshme. Siç shihet edhe nga grafiku pjesa më e madhe e respondentëve i takojnë profesionit fermer, pasuar nga ekonomistët, amivse, mësimdhënës, inzhinier si dhe automekanik. Ndërsa profesionet e tjera janë me numër të vogël. Gjithsesi vlen të përmendet se në bazë të informacioneve që kemi marrë është fat i madh se të rinjtë e diplomuar të kategorisë fermer respektivisht kanë arritur të sigurojnë një vend pune, për dallim prej profesioneve të tjera që më me vështirësi kanë arritur të qasen në tregun e punës ose edhe janë të detyruar të punojnë një punë tjetër jashtë profesionit të tyre.

Tabela 9: Punësimi i të anketuarve

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|-----------------|--------------|------------|----------------------|----------------------|
| Valid id | Po | 52 | 52.0 | 52.0 |
| | Jo | 48 | 48.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Në lidhje me punësimin 52 nga të anketuarit apo 52.0% e tyre kanë deklaruar se janë të punësuar, ndërsa 48 prej tyre apo 48.0% kanë deklaruar se nuk janë të punësuar, pra nuk kanë një punë të rregullt mirëpo varen nga aktivitete të tjera.

Tabela 10: Sektori i punësimit të respondentëve

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|------------------------|------------|----------------------|----------------------|
| Valid | Sektorin Publik | 18 | 35.3 | 35.3 |
| | Sektorin Privat | 34 | 64.7 | 100.0 |
| | Total | 51 | 100.0 | |
| | Te pa punesua | 48 | | |
| Total | | 100 | | |

Nga gjithsej 51 të anketuar të cilët kanë deklaruar se janë të punësuar 18 prej tyre apo 18.0% janë të punësuar në sektorin publik, ndërsa 34 të anketuar apo 34.0% prej tyre janë të punësuar në sektorin privat. 48 prej të gjithë të anketuarve nuk janë të punësuar fare, çka do të thotë se nuk janë pjesë as e sektorit publik dhe as e sektorit privat.

Tabela 11 : Zona e punësimit të respondentëve

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|---------------|------------|----------------------|----------------------|
| Valid | Rurale | 24 | 47.1 | 47.1 |
| | Urbane | 28 | 52.9 | 100.0 |
| | Total | 51 | 100.0 | |
| | 0 | 48 | | |
| Total | | 100 | | |

Nga të gjithë të punësuarit e deklaruar, 24 prej tyre apo 24.0% kanë deklaruar se janë të punësuar në zonë rurale, ndërsa 28 të anketuar apo 28.0% prej tyre kanë deklaruar se janë të punësuar në zonë urbane, ndryshe nga 48 të anketuar të cilët nuk janë fare të punësuar në asnjërin prej sektorëve dhe në asnjërën prej zonave. Në bazë të kësaj kuptojmë se zonat urbane ofrojnë më tepër kushte për punësim në krahasim me zonat rurale gjë që i bënë më atraktive për qytetarët dhe më tërheqëse për të lëvizur drejt tyre.

Tabela 12: Numri i anëtarëve të familjes

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|--------------|------------|----------------------|----------------------|
| Val id | 10 | 1 | 1.0 | 1.0 |
| | 11 | 1 | 1.0 | 2.0 |
| | 2 | 3 | 3.0 | 5.0 |
| | 3 | 11 | 11.0 | 16.0 |
| | 4 | 20 | 20.0 | 36.0 |
| | 5 | 20 | 20.0 | 56.0 |
| | 6 | 19 | 19.0 | 75.0 |
| | 7 | 14 | 14.0 | 89.0 |
| | 8 | 10 | 10.0 | 99.0 |
| | 9 | 1 | 1.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Në lidhje me numrin e anëtarëve të familjes, të anketuarit kanë deklaruar se familjet e tyre përbëhen prej 2 deri në 11 anëtarë. 1 i anketuar apo 1.0% e të gjithë të anketuarve kanë deklaruar se familja e tyre përbëhet prej 10 anëtarëve, 1 i anketuar kanë deklaruar se kanë 11 anëtarë të familjes, 3 të tjerë kanë deklaruar se familja e tyre përbëhet prej 2 anëtarëve. Më tutje gjithsej 11 respondent kanë deklaruar se numri i anëtarëve të familjes së tyre është 3, 20 respondent kanë deklaruar se numri anëtarë të familjes është 4, ndërsa 20 respektivisht 20.0% kanë deklaruar se familja e tyre përbëhet nga 5 anëtarë. Nga pjesa e mbetur e respondentëve 19 prej tyre apo 19.0% kanë deklaruar se kanë 6 anëtarë të familjes, 14 të anketuar apo 14.0% kanë deklaruar se kanë 7 anëtarë të familjes, 10 të anketuarve ka deklaruar se familja përbëhet nga 8 anëtarë, si dhe së fundi 1 i anketuar apo 1.0% tyre kanë deklaruar se kanë gjithsej 9 anëtarë të familjes.

Tabela 13: Numri i anëtarëve të punësuar në familje

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|------------------------|------------|----------------------|----------------------|
| Valid | Nje | 51 | 56.7 | 56.7 |
| | Dy | 28 | 31.1 | 87.8 |
| | Tre | 9 | 10.0 | 97.8 |
| | Me teper se tre | 2 | 2.2 | 100.0 |
| | Asnje | 10 | 100.0 | |
| Total | | 100 | | |
| Total | | 100 | | |

Kur respondentët janë pyetur së sa prej anëtarëve të familjes së tyre janë të punësuar, ata kanë dhënë përgjigje të ndryshme duke filluar prej një anëtarë, dy, tre, më tepër se tre dhe disa prej tyre kanë deklaruar se nuk kanë asnjë të punësuar në familje. Në bazë të rezultateve që shihen edhe nga tabela, 51 të anketuar apo 51.0% e tyre kanë deklaruar se kanë vetëm një anëtarë të familjes të punësuar, 28 të anketuar apo 28.0% e tyre kanë deklaruar se në familjen e tyre punojnë dy persona, 9 të anketuar apo 9.0% e tyre kanë deklaruar se kanë tre anëtarë të familjes të punësuar, ndërsa 2 të anketuar apo 2.0% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë më tepër se tre anëtarë të punësuar në familjen e tyre, për dallim prej 10 të anketuarve të tjerë respektivisht 10.0% e të anketuarve të cilët kanë deklaruar se në familjen e tyre asnjë prej anëtarëve nuk është i punësuar.

Tabela 14: Burimet e të ardhurave të të anketuarve

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|-----------------|------------|----------------------|----------------------|
| Valid | Nje | 55 | 54.5 | 54.5 |
| | Me teper | 45 | 45.5 | 100.0 |
| | Total | 99 | 100.0 | |
| Total | | 100 | | |

Sa i përket burimeve të të ardhurave të respondentëve, 55 respondentë apo 55.0% prej tyre kanë deklaruar se kanë vetëm një burim të të ardhurave, ndërsa 45 të anketuar apo 45.0% prej tyre kanë deklaruar se kanë më tepër burime nga të cilat ata i sigurojnë të ardhurat.

Tabela 15 : Mbulimi i shpenzimeve me vetëm një të ardhur

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|--------------------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Valid | Po, mund ti mbuloje | 55 | 55.0 | 55.0 |
| | Jo, nuk mund ti mbuloje | 45 | 45.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Kur respondentët janë pyetur se a mund ti mbulojnë shpenzimet e tyre vetem me nje lloj të ardhurash apo është e domosdoshme edhe ndonjë burim tjetër, pjesa më e madhe e tyre kanë deklaruar se ka mundësi që me vetëm një burim t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet e tyre. Me konkretisht prej 100 të anketuarve 55 prej tyre apo 55.0% kanë deklaruar se arrijnë t'i mbulojnë shpenzimet me vetëm një burim të të ardhurave, ndërsa 45 prej të anketuarve apo 45.0% e tyre kanë deklaruar se nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e tyre me vetëm një burim por është e domosdoshme edhe ndonjë burim tjetër nga i cili mund t'i sigurojnë të ardhurat e tyre.

Tabela 16: Burimet e të ardhurave që i përdorin më shumë respondentët

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|---|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Val id | Paga nga institucionet publike | 31 | 31.0 | 31.0 |
| | Paga nga institucionet private | 36 | 36.0 | 67.0 |
| | Te ardhurat nga bujqesia,pylltaria, blegtoria etj. | 33 | 33.0 | 100.0 |
| | Ndihma sociale | 13 | 13.0 | |
| | Pensione | 22 | 22.0 | |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Nga gjithsej 100 të anketuarit, pjesa më e madhe respektivisht 36 prej tyre apo 36.0% kanë deklaruar se paga nga institucionet private është burimi kryesor në të cilin mbështeten të ardhurat e tyre, 31 të anketuar apo 31.0% kanë deklaruar se të ardhurat e tyre i sigurojnë nga institucionet publike, ndërsa 33 të anketuar të tjerë apo 33.0% e tyre kanë deklaruar se të ardhurat nga bujqësia, blegtoria, pylltaria janë lloji i të ardhurave që ata i përdorin më së shumti dhe varen prej tyre. Më tutje 13 të anketuar apo 13.0% kanë deklaruar se kanë të ardhura edhe nga ndihma sociale, 22 të anketuar tjerë kanë deklaruar se marrin pensione edhe pse nuk është burimi kryesor i të ardhurave. Pra siç shihet jo të gjithë të anketuarit të ardhurat e tyre i sigurojnë prej vetëm një burimi, mirëpo personat e ndryshëm kanë burime të ndryshme të të ardhurave nga të cilat varen.

Tabela 17 : Aktivitetet nga të cilat sigurohen të ardhurat

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|------------------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Val id | Aktivitetet bujqësore | 30 | 30.0 | 30.0 |
| | Jo bujqësore | 30 | 30.0 | 60.0 |
| | Te dyjat | 40 | 40.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Aktivitetet jobujqësore përbëjnë aktivitetet kryesore nga të cilat respondentët i sigurojnë të ardhurat e tyre. 30 të anketuar apo 30% e të anketuarve kanë deklaruar se të ardhurat e tyre i sigurojnë kryesisht nga aktivitetet bujqësore, 30 prej të anketuarve apo 30% kanë deklaruar se të ardhurat e tyre i sigurojnë nga aktivitetet jobujqësore, ndërsa 40 prej të anketuarve apo 40% prej tyre kanë deklaruar se të ardhurat e tyre i sigurojnë prej të dyja llojeve të aktiviteteve, si nga aktivitetet bujqësore ashtu edhe nga aktivitetet jobujqësore.

Tabela 18: Degët e bujqësisë me të cilat merren të anketuarit

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|--------------|--------------------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| Valid | Blegtori | 8 | 11.4 | 11.4 |
| | Pemëtari | 8 | 11.4 | 22.9 |
| | Lavërtari dhe perimtari | 9 | 12.9 | 35.7 |
| | Vreshtari | 1 | 1.4 | 37.1 |
| | Bletari | 5 | 7.1 | 44.3 |
| | BMA | 39 | 55.7 | 100.0 |
| | Total | 70 | 100.0 | |
| | Asnje | 30 | | |
| | Total | 100 | | |

Të anketuarit të cilët merren me aktivitete bujqësore kanë deklaruar se BMA-t është dega kryesore e bujqësisë me të cilat merren. Më konkretisht 39 të anketuar apo 39.0% e tyre kanë deklaruar se dega kryesore e bujqësisë me të cilën ata merren është BMA-t, 8 të anketuar apo 8.0% merren me blegtori, 8 të anketuar apo 8.0% merren me pemëtari, 9 të anketuar të tjerë apo 9.0% poashtu kanë deklaruar se lavërtaria dhe perimtaria janë degët e bujqësisë me të cilat merren, 5 të anketuar apo 5.0 % merren me bletari, ndërsa vetëm 1 apo 1.0 % i të anketuarve ka deklaruar se merret me vreshtari. Mirëpo pjesa tjetër e të anketuarve respektivisht 30 apo 30.0% nga të gjithë të anketuarit kanë deklaruar se nuk merren me asnjërin prej degëve të bujqësisë, dhe se të ardhurat e tyre i sigurojnë vetëm prej aktiviteteve jobujqësore.

Tabela 19 : Ndikimi i bujqësisë në zhvillimin ekonomik të zones

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|------------------------------|------------|----------------------|----------------------|
| Val id | Nuk ka ndikim | 3 | 3.0 | 3.0 |
| | Mesatarisht ka ndikim | 9 | 9.0 | 12.0 |
| | Ka ndikim | 38 | 38.0 | 50.0 |
| | Ka shumë ndikim | 50 | 50.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Sa i përket asaj se sa të anketuarit mendojnë se bujqësia ka ndikim në zhvillimin ekonomik të zonës së tyre, 3 nga të anketuarit apo 3.0 % e tyre kanë deklaruar se bujqësia nuk ka ndikim në zhvillimin ekonomik të zonës së tyre, 9 të anketuar apo 9.0% mendojnë se bujqësia mesatarisht ka ndikim në zhvillimin ekonomik, 38 të anketuar apo 38.0% mendojnë se bujqësia ndikon në zhvillimin ekonomik, ndërsa pjesa më e madhe e tyre respektivisht 50 apo 50.0% e të anketuarve mendojnë se bujqësia ka shumë ndikim në zhvillimin ekonomik të tyre, madje një pjesë e tyre këtë mendim e ndajnë edhe pse nuk zhvillojnë aktivitete bujqësore.

Tabela 20: Të ardhurat mujore të të anketuarve

| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
|---------------|-----------------|------------|----------------------|----------------------|
| Val id | 100-200 | 2 | 2.0 | 2.0 |
| | 201-400 | 29 | 29.0 | 31.0 |
| | 401-600 | 33 | 33.0 | 64.0 |
| | 601-800 | 24 | 24.0 | 88.0 |
| | 801-1000 | 8 | 8.0 | 96.0 |
| | Mbi 1000 | 4 | 4.0 | 100.0 |
| | Total | 100 | 100.0 | |

Lidhur me të ardhurat mujore, të anketuarit kanë deklaruar se kanë të ardhura të ndryshme varësisht sipas aktiviteteve të tyre të cilat i kryejnë. Ata kanë deklaruar se kanë të ardhura nga 100 deri në mbi 1000 euro për një muaj. Vetem 2 të anketuar kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore 100-200 euro, 29 të anketuar apo 29.0% e tyre kanë deklaruar se të ardhurat e tyre

mujore janë prej 201 deri në 400 euro, 33 nga te anketuarit apo 33.0% kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore prej 401 deri në 600 euro. Më tutje 24 të anketuar apo 24.0% e tyre kanë deklaruar se të ardhurat e tyre mujore janë prej 601 deri në 800 euro, 8 të anketuar apo 8.0% e tyre kanë deklaruar se kanë të ardhur mujore prej 801 deri në 1000 euro, ndërsa 4 prej tyre apo 4.0% kanë deklaruar se të ardhurat e tyre mujore varësisht sipas aktiviteteve dhe punës që kryejne janë mbi 1000 euro.

Tabela 21: Të ardhurat vjetore nga institucionet publike

| 2015 | | | | |
|-----------------|------------------|------------|----------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 3 | 10.3 | 10.3 |
| | Mbi 4000 | 26 | 89.7 | 100.0 |
| | Total | 29 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 71 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2016 | | | | |
|-----------------|------------------|------------|----------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 4 | 12.5 | 12.5 |
| | Mbi 4000 | 28 | 87.5 | 100.0 |
| | Total | 32 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 68 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2017 | | | | |
|-----------------|------------------|------------|----------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 4 | 12.5 | 12.5 |
| | Mbi 4000 | 28 | 87.5 | 100.0 |
| | Total | 32 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 68 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2018 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 5 | 15.2 | 15.2 |
| | Mbi 4000 | 28 | 84.8 | 100.0 |
| | Total | 33 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 67 | | |
| Total | | 100 | | |

Lidhur me të ardhurat vjetore kemi marrë informacione për gjithsej 4 vite prej vitit 2015 deri në vitin 2018, në mënyrë që të mund të bëjmë krahasime ndër vite. Kështu sa i përket të ardhurave nga institucionet publike gjatë vitit 2015, 3 të anketuar apo 3.0% kanë deklaruar se kanë pasur të ardhura vjetore 2000 deri në 40000 euro, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve saktësisht 26 prej tyre apo 26.0% kanë deklaruar se kishin të ardhura vjetore mbi 4000 euro. Pjesa më e madhe e të anketuarve respektivisht 71 prej tyre apo 71.0% kanë deklaruar se fare nuk e kanë pasur këtë lloj të ardhure.

Në vitin 2016, 4 të anketuar apo 4.0% e tyre kanë deklaruar se kanë pasur të ardhura vjetore nga institucionet publike prej 2000-4000 euro, ndërsa 28 apo 28.0% e të anketuarve kanë deklaruar se të ardhurat vjetore nga institucionet publike i kishin mbi 4000 euro. Për dallim nga këta, 68 të anketuar apo 68% e tyre kanë deklaruar se këtë të ardhur nuk e kanë pasur.

Në vitin 2017, 28 të anketuar apo 28% kanë deklaruar se nga institucionet publike kanë siguruar të ardhura mbi 4000 euro, ndërsa 68 apo 68.0% kanë deklaruar se nuk e kishin këtë të ardhur. Njësoj janë rezultatet edhe për vitin 2018. Nga kjo mund të themi se të ardhurat vjetore nga institucionet publike janë stabile, dhe janë rritur prej vitit 2015 deri në vitin 2018.

Tabela 22: Të ardhurat vjetore nga institucionet private

| 2015 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 16 | 32.7 | 32.7 |
| | Mbi 4000 | 33 | 67.3 | 100.0 |
| | Total | 49 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 51 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2016 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 16 | 32.7 | 32.7 |
| | Mbi 4000 | 33 | 67.3 | 100.0 |
| | Total | 49 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 51 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2017 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 14 | 28.6 | 28.6 |
| | Mbi 4000 | 35 | 71.4 | 100.0 |
| | Total | 49 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 51 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2018 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 2000-4000 | 15 | 30.6 | 30.6 |
| | Mbi 4000 | 34 | 69.4 | 100.0 |
| | Total | 49 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 51 | | |
| Total | | 100 | | |

Rreth 51 të anketuar apo 51.0% deklaruan se këtë të ardhur nuk e kanë fare, por i sigurojnë të ardhurat e tyre nga burime apo aktivitete të tjera. Të ardhurat vjetore nga institucionet private në vitin 2015 ishin 2000 deri në 4000 euro ishin të ardhurat vjetore për 16 të anketuar apo 16.0%, ndërsa 49 të tjerë të anketuar apo 49.0% kanë deklaruar se kanë të ardhura vjetore prej insitucioneve publike mbi 4000 euro. Në vitin 2016, 16 të anketuar apo 16.0% kanë deklaruar se kanë pasur të ardhura vjetore 2000 deri në 4000 euro, ndërsa 33 të anketuar apo 33.0% kanë deklaruar se të ardhurat vjetore nga institucionet private i kishin mbi 4000 euro. Në vitin 2017, 14 apo 14.0% e të anketuarve deklaruan se kishin të ardhura vjetore 2000 deri në 4000 euro, ndërsa 35 të anketuar të tjerë apo 35.0% deklaruan se këtë të ardhur e kishin mbi 4000 euro. Njësoj janë të dhënat edhe për vitin 2018.

Tabela 23: Të ardhurat vjetore nga bujqësia

| 2015 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 500-2000 | 2 | 3.1 | 3.1 |
| | 2000-4000 | 30 | 46.2 | 49.2 |
| | Mbi 4000 | 33 | 50.8 | 100.0 |
| | Total | 65 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 35 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2016 | | | | |
|-----------------|------------------|------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 500-2000 | 2 | 3.1 | 3.1 |
| | 2000-4000 | 29 | 44.6 | 47.7 |
| | Mbi 4000 | 34 | 52.3 | 100.0 |
| | Total | 65 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 35 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2017 | | | | |
|----------|-----------|-----------|----------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 500-2000 | 2 | 3.0 | 3.0 |
| | 2000-4000 | 20 | 30.3 | 33.3 |
| | Mbi 4000 | 44 | 66.7 | 100.0 |
| | Total | 66 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 34 | | |
| Total | | 100 | | |

| 2018 | | | | |
|----------|-----------|-----------|----------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja e vlefshme | Përqindja komulative |
| Valid | 500-2000 | 2 | 3.1 | 3.1 |
| | 2000-4000 | 20 | 30.8 | 33.8 |
| | Mbi 4000 | 43 | 66.2 | 100.0 |
| | Total | 65 | 100.0 | |
| Missi ng | System | 35 | | |
| Total | | 100 | | |

